Numër: 01/128
Datë: 31.03.2023

Në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit Nr.03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, si dhe Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) Nr.35-2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve qe ofrojnë kualifikime ne Kosove, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 27.03.2023 nxjerrë këtë:

V E N D I M

1. **Akreditohet** institucioni "SIDI - EDUCATION" SH.P.K, me adresë: Rr. Abedin Sogojeva, kompleksi Dardania, Hyrja D3, Kati 1, Nr.1-2, Fushë Kosovë, si dhe me nga një qendër në: Gjilan, Ferizaj, Mitrovicë, Skenderaj, dhe në Pejë, Republika e Kosovë, për periudhën tre (3) vjeçare, përkatësisht nga data 27.03.2023 deri 26.03.2026, për të ofruar, vlerësuar dhe certifikuar këtë kualifikim:

   1.1 Kurse Të Gjuhës Angleze, niveli A1 deri në C2, sipas KPERGJ-së, institucioni mund të realizojë procesin e aftësimit e aftësimit sipas të dhënave të mëposhtme:

   1.1.1. Fushë Kosovë, me adresë: Rr. Abedin Sogojeva, kompleksi Dardania, Hyrja D3, Kati 1, Nr.1-2, Fushë Kosovë: Institucioni mund të realizoj procesin e aftësimit deri me dymbëdhjetë (12) kandidat në një grup dhe gjatë një viti mund të ketë deri në 8 grupe për një mësimdhënës, respektivisht 2 mësimdhënës x 8 grupe x 12 kandidatë =192 kandidatë.

   1.1.2. Mitrovicë, me adresë: Rr. Marsi, Nr.81, Mitrovicë: Institucioni mund të realizoj procesin e aftësimit deri me dymbëdhjetë (12) kandidat në një grup dhe gjatë një viti mund të ketë deri në 8 grupe për një mësimdhënës, respektivisht 4 mësimdhënës x 8 grupe x 12 kandidatë = 384 kandidatë.

   1.1.3. Skenderaj, me adresë: Salë e Hamit Jashari, Nr.103, Skenderaj: Institucioni mund të realizoj procesin e aftësimit deri me dymbëdhjetë (12) kandidat në një grup dhe gjatë një viti mund të ketë deri në 8 grupe për një

mësimdhënës, respektivisht 5 mësimdhënës x 8 grupe x 12 kandidatë = 480 kandidatë.

1.1.4. Pejë, me adresë: Rr. Enver Hadri, Nr.25, Pejë: Institucioni mund të realizoj procesin e aftësimit deri me dymbëdhjetë (12) kandidat në një grup dhe gjatë një viti mund të ketë deri në 8 grupe për një mësimdhënës, respektivisht 2 mësimdhënës x 8 grupe x 12 kandidatë = 192 kandidatë.

1.1.5. Ferizaj, me adresë: Rr. Vëllezërit Gërvalla, p.n. Ferizaj: Institucioni mund të realizoj procesin e aftësimit deri me dymbëdhjetë (12) kandidat në një grup dhe gjatë një viti mund të ketë deri në 8 grupe për një mësimdhënës, respektivisht 2 mësimdhënës x 8 grupe x 12 kandidatë = 192 kandidatë.

1.1.6. Gjilan, me adresë: Lagjja Dardania 1, Rr. E VII -të, B. Musliu, Nr.187, Gjilan: Institucioni mund të realizoj procesin e aftësimit deri me dymbëdhjetë (12) kandidat në një grup dhe gjatë një viti mund të ketë deri në 8 grupe për një mësimdhënës, respektivisht 6 mësimdhënës x 8 grupe x 12 kandidatë = 576 kandidatë.

2. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Në bazë të kërkesës së "SIDI - EDUCATION", për akreditim dhe rekomandimeve të dala nga Raporti i ekipit të ekspertëve mbi akreditimin e institucionit, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Rekomandimet përfundimtare të ekipit të ekspertëve janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara nga institucioni në fazën e aplikimit: Aplikacionin për akreditim si institucion ofrues dhe/ose vlerësues dhe lëshues të kualifikimit; Raportin e Vetëvlerësimit; Vizitën në institucionin/ofruesin aplikues, si dhe dokumente tjera shtesë.

Pas trajtimit në detaje nga ekipi i ekspertëve të dokumentacionit të sipërpërmendur dhe të gjeturave nga vizita, ekipi i ekspertëve në raportin e hartuar dha vlerësim pozitiv, dhe të njëjtin ia rekomandoi Këshillit Drejtues për vendimmarrje. Mbi këtë bazë, Këshilli Drejtues, bazuar në kompetencat e tij, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pikat 1, 2, 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ të MASHT për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me Nr. 35/2014. Ankesa

kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD të AKK, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.

Vendimi u dërgohet:

1. Institucionit, SIDI - EDUCATION, dhe
2. Arkivit të AKK-së.

Besim MUSTAFA, PhD,EDBA

Kryetar i KD të AKK